


TaxNews

July 2020
Korrik 2020



I. Ndryshime në VKM "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014 "Për TVSH-në""

Me efekt nga data 01.01.2021, kufiri minimal për regjistrimin për TVSH do të jetë qarkullimi vjetor prej 10 milionë lekë (*deri më 31.12.2020, kufiri minimal do të vijojë të jetë qarkullimi vjetor prej 2 milionë lekë*). Tatimpaguesit me qarkullim vjetor më të ulët se 10 milionë lekë do të kenë të drejtën të zgjedhin të regjistrohen për TVSH (apo të vijnë të regjistruar për TVSH) vetëm nëse qarkullimi vjetor i tyre do të jetë më i lartë se 5 milionë lekë.

Sa më sipër do të zbatohet edhe mbi:

- Personat që ofrojnë shërbime nëpërmjet ushtrimit të profesioneve të lira, për të cilët kufiri i regjistrimit për TVSH është aktualisht zero, si dhe
- Prodhuesit bujqësorë nën regjimin e veçantë të skemës së kompensimit (fermerët individualë), për të cilët kufiri i regjistrimit për TVSH është aktualisht 5 milionë lekë.

Këto ndryshime janë publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 139, datë 29.07.2020 nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 576, datë 22.07.2020, "Për disa ndryshime në VKM nr. 953, datë 29.12.2014 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014 "Per TVSH-në"".

I. Amendments to the DCM "On the implementing provisions of law no. 92/2014 "On VAT""

With effect from 01.01.2021, the minimum limit for VAT registration will be the annual turnover of ALL 10 million (*until 31.12.2020, the minimum limit will continue to be the annual turnover of ALL 2 million*). Taxpayers with annual turnover of less than ALL 10 million will have the right to choose to register for VAT (or continue to be registered for VAT) only if their annual turnover will exceed ALL 5 million.

The above will also apply to:

- Persons providing services through the exercise of freelance professions, for which the VAT registration limit is currently zero, as well as;
- Agricultural producers under the special regime of the compensation scheme (individual farmers), for which the VAT registration limit is currently ALL 5 million.

These amendments are published in the Official Gazette no. 139, dated 29.07.2020 through the Decision of the Council of Ministers (DCM) no. 576, dated 22.07.2020, "On some amendments to the DCM no. 953, dated 29.12.2014 "On the implementing provisions of law no. 92/2014 "On VAT"".

II. Shtyrje e afatit të zbatimit të Ligjit "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme"

Afati i zbatimit të Ligjit nr. 90/2019 "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme" shtyhet nga data 30.09.2020 në datën 31.12.2020 (pra, me tre muaj). Ky ligj, i cili hyri në fuqi më 14.01.2020 për një afat të kufizuar, u jep të drejtën e rivlerësimit të pasurisë me vlerën e tregut:

- Individëve që kanë pronësi pasuri të paluajtshme si dhe ata që zotërojnë pasuri të paluajtshme në proces regjistrimi, si dhe
- Personave juridikë që zotërojnë pasuri të paluajtshme.

Një përmbledhje të parashikimeve të këtij ligji e gjeni në edicionin e Special Tax News të Paketës Fiskale 2020 të publikuar nga Deloitte Albania në janar 2020.

Shtyrja e afatit është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 136, datë 21.07.2020 nëpërmjet Ligjit nr. 91/2020 "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 90/2019 "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme".

III. Shtyrje e afatit për fillimin e zbatimit të Ligjit "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit"

Shtyhet afati për fillimin e zbatimit të Ligjit nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" nga data 01.09.2020 në datë 01.09.2021 për transaksionet me para në dorë për të gjithë tatim-paguesit, pavarësisht përgjegjësisë tatimore apo qarkullimit vjetor të realizuar.

II. Extension of the deadline for the implementation of the Law "On revaluation of immovable property"

The deadline for implementation of Law no. 90/2019 "On revaluation of immovable property" has been extended from 30.09.2020 to 31.12.2020 (i.e. by three months). This law, which entered into force on 14.01.2020 for a limited period, gives the right to revalue the property at market value to:

- Individuals who own immovable properties as well as those who own immovable properties in the registration process, and
- Legal persons that own immovable properties.

Please find a summary of the provisions of this law in the Special Tax News edition of the Fiscal Package 2020 published by Deloitte Albania in January 2020.

The extension of the deadline is published in the Official Gazette no. 136, dated 21.07.2020 through the Law no. 91/2020 "On some amendments in Law no. 90/2019 "On revaluation of immovable property".

III. Postponement of the deadline for the initiation of implementation of the Law "On invoice and turnover monitoring system"

The deadline for the initiation of implementation of the Law no. 87/2019 "On invoice and turnover monitoring system" has been postponed from 01.09.2020 to 01.09.2021 for cash transactions for all taxpayers, regardless of the tax responsibility or annual turnover.

Në tabelën më poshtë paraqiten afatet e deritanishme dhe afatet e reja të fillimit të zbatimit të Ligjit sipas kategorive përkatëse të transaksioneve dhe tatimpaguesve:

Lloji i transaksionit dhe tatimpaguesit	Afati i deritanishëm	Afati i ri
Për transaksionet me para në dorë nga tatimpaguesit subjekt të TVSH dhe tatim fitimit me qarkullim vjetor mbi 8 milionë lekë	1 shtator 2020	1 shtator 2021
Transaksionet me para në dorë nga tatimpaguesit subjekt të TVSH dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me një qarkullim vjetor midis 2 milionë lekë dhe 8 milionë lekë Transaksionet me para në dorë nga tatimpaguesit subjekt të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me një qarkullim vjetor deri në 2 milionë lekë	1 janar 2021	1 shtator 2021
Transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve dhe organeve publike	1 janar 2021	1 janar 2021
Transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve	1 korrik 2021	1 korrik 2021

The following table presents the current deadlines and new deadlines according to the respective categories of transactions and taxpayers:

Type of transaction and taxpayer	Current deadline	New deadline
Cash transactions by taxpayers subject to VAT and corporate income tax (CIT) with an annual turnover exceeding ALL 8 million	1 September 2020	1 September 2021
Cash transactions by taxpayers subject to VAT and simplified CIT with an annual turnover between ALL 2 million and ALL 8 million Cash transactions by taxpayers subject to simplified CIT with an annual turnover up to ALL 2 million	1 January 2021	1 September 2021
Cashless transactions between taxpayers and public government bodies	1 January 2021	1 January 2021
Cashless transactions between taxpayers	1 July 2021	1 July 2021

Shtyrja e afatit është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 146, datë 07.08.2020 nëpërmjet Ligjit nr. 108/2020 datë 29.07.2020 "Për një ndryshim në ligjin nr. 87/2019, "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit".

The postponement of the deadline is published in the Official Gazette no. 146, dated 07.08.2020 through Law no. 108/2020 "On an amendment to law no. 87/2019, "On invoice and turnover monitoring system".

IV. Shtesa dhe ndryshime në Ligjin "Për procedurat tatimore"

Pajisjet fiskale të ofruara nga shoqëritë e autorizuar do të vijojnë të funksionojnë dhe të mirëmbahen nga këto shoqëri për aq kohë sa ato nuk bien në kundërshtim me ligjin nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit".

Ky parashikim dhe disa shtesa të tjera janë publikuar ne Fletoren Zyrtare nr. 146, datë 07.08.2020 nëpërmjet Ligjit nr. 110/2020 datë 29.07.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".

IV. Additions and amendments to Law "On tax procedures"

Fiscal equipments provided by authorized entities will continue to operate and be maintained by these entities as long as they do not contradict with law no. 87/2019 "On invoice and turnover monitoring system".

This provision and some other additions have been published in the Official Gazette no. 146, dated 07.08.2020 through Law no. 110/2020 "On some additions and amendments to the law no. 9920, dated 19.05.2008, "On tax procedures in the Republic of Albania", as amended".

Deloitte Contacts

Olindo Shehu, CPA

Partner | Tax & Legal Services
Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Faik Konica",
Ndërtesa nr.6, Hyrja nr. 7
1010, Tirana, Albania
Mob: +355 68 60 33 116
E-mail: oshehu@deloitteCE.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 312,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.